



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 3

Rrogozhinë, më 20.03.2025 ora 12 : 00^{oo}

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës Njoftim, të thirrur nga Kryetarja e Këshillit Bashkiak, me shkresën Nr.1129.Prot datë 13.03.2025 me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.2, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 24.02.2025.
- 3- Shqyrtim i vlefshmërisë së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak z. Isa Halili.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2025 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 6- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë”.
- 7- Miratim i projekt - vendimit, “Për vlerësimin e aplikantëve për përfitimin nga programi ‘Subvencionimi i Interesave të Kredisë për vitin 2025’ ”.
- 8- Informim i Këshillit mbi , “Parandalimin e dhunës me bazë gjinore”.
- 9- Shqyrtim i problematikës së ndërprerjes së energjisë elektrike në Bashkinë Rrogozhinë.
- 10- Të ndryshme.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Shpati Kolgega, Fatmira Thartori, Gezime Met-hasani, Enver Memolla, Alime Hoxha, Altin Tosku, Lorena Baku, Sokol Gosa, Saimir Cani, Besnike Coraj, Merilin Saraçi, Lije Dedej, Indrit Dedej, Silvana Aliu, Hekuran Xhani, Mukades Gixhari.

Mungojnë :



Isa Halili, Mitat Daja, Lulzim Hasa, Renato Kalemi, Erind Tosku.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkyetar i Bashkisë.
3. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
4. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
5. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
6. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
7. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
8. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
9. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.
10. Artur Kaja - Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve.
11. Adriatik Leka - Përgjegjës i Emergjencave Civile.
12. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.
13. Sidorela Aliu - Specialiste e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : 15 Këshilltarë, znj. Alime Hoxha i bashkohet mbledhjes në minutën e dytë të zhvillimit të saj duke e çuar në 16 numrin e këshilltarëve në sallë, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përhëndetje të nderuar Këshilltarë ! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm për mbledhje e deklaroj zyrtarisht të hapur. Marrin pjesë në mbledhje : z. Shpati Kolgega, znj. Fatmira Thartori, znj . Gezime Met-hasani, z. Enver Memolla, z. Altin Tosku, znj. Lorena Baku, z.Sokol Gosa, Saimir Cani, znj. Besnike Coraj, znj. Merilin Saraçi, znj. Lije Dedej, z. Indrit Dedej, znj. Silvana Aliu, z. Hekuran Xhani, znj. Mukades Gixhari.

-Lexojmë Vendimet me karakter individual që u morën në mbledhjen e këshillit të datës



24.02.2025 të cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar janë si më poshtë :

Vendimi nr .5. “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2025 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%” .

Vendimi nr .6. “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt2025 nga fondi i pushtetit vendor.

-Lexojmë dhe konfirmimin ligjor për vendimet e këshillit bashkiak me karakter normativ të datës 24.02.2025 të ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Vendim nr .7. “Për lejimin e përdorimit (aksesit) të rrugës së kalimit në lagjen nr.1, mbi stacionin e trenit, Rrogozhinë nga banorët e lagjes”.

Nuk konfirmohet pasi nuk shtë kompetencë e Këshillit Bashkiak referuar nenit 54, ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar. Objekti i vendimit referuar legjislacionit në fuqi cilësohet konflikt civil dhe sipas dokumnetacionit shoqërues të tij, aktualisht është objekt shqyrtimi në juridiksionin gjyqësor.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin. Prefekt. Afrim Qëndro.

-Mbledhjes i bashkohet znj. Alime Hoxha në minutën e dytë të zhvillimit të saj.

Indrit Dedej . Ndoshta Prefekti nuk është i qartë sepse gjyqi civil nuk ka filluar akoma ato janë hedhur në gjyq civil por nuk ka marrë datë gjyqi civil që të marrë vendim sepse kur të fillojë gjyqi unë e di që gjykata jep një vendim për hapjen e rrugës deri në mbarim të gjyqit për konfliktin e banorëve. Edhe duke pasur parasysh që për parcelën 205/66 që ka bërë kërkesë bashkia , parcela që është rruga ka ardhur dhe nuk e di pse nuk e ka sjellë bashkia është tokë shtet, a kupton? Ka ardhur në bashki ajo ne e kërkuam dje ato nuk e kanë sjellur . Tani unë them që ne ta marrim një vendim që komisionin mos ndalojmë komisionin e bashkisë për rihapjen e rrugës konfliktin . Duke marrë shkas dhe nga letrat që solli komisiariati i Kavajës them që ta marrim se dhe komisiariati i Kavajës i është drejtuar Këshillit për të marrë një vendim të tillë.

Enver Memolla . Ky është një konflikt i mbartur këtë e dimë, kemi diskutuar dhe para ca muajsh para ca vitesh. Ka një problem të madh ajo parcelë toke atje lart pjesa e hartës kadastrale sepse po më thonë dhe kam informacion sepse kam takuar dhe drejtorin e urbanistikës sot, i jam drejtuar vetë dhe personit që ka parcelën.Është një problem i lindur dhe i mbartur dhe këtë problem e zgjidh vetëm bashkia Rrogozhinë.Këtu nuk ndërhyt më dot këshilli bashkiak sepse zotëria është pronar i parcelësme dokumenta është hapur një proces gjyqësor nuk ka nisur por në moment që fillon gjyqi nuk ka më të drejtë këshilli bashkiak që të marrë vendim sepse është kompetencë e gjykatës dhe nuk del këshilli mbi gjykatën ndaj dhe prefekti e ka cilësuar këtë lloj



gjëje. Por këtu ka zanafillë dhe këtu do ulur me këmbë në tokë bashkia Rrogozhinë, zanafilla nis nga fitimi i gjyqit të parë ku nuk është likuiduar zotëria i sorollatjes së mosshlyerjes së detyrimit të parë. Pak më parë i kërkova sekretarit një informacion mbi vendimin e këshillit që është marrë në 2019 kur ishte dhe i ndjeri Haxhi Memolla kryetar, kur filloi dhe rruga e re që u bë sipas zotërisë kishte dokumentacion dhe ai projekt i ka prekur në atë parcelë dhe në atë parcelë zotëria është i gatshëm që të bashkëpunojë me zotërinë... unë jam thashë me personin njihem me të gjithë personat njihemi bashkë , me personin kam folur si anëtar këshilli dhe them çfarë ka thënë zotëria se po flas dhe me lejen e zotërisë nuk flas dot tek ajo pjesë. Tani zotëria ehe për tokën lart se ka qenë një projekt për ta bërë dhe park lojërash atë lagje park lojërash për fëmijët dhe pleqtë është dakord të ulet dhe të bashkëpunojë me bashkinë që dhe bashkia të bëjë një plan urbanistik për atë zonë aty ku cilësohet edhe rruga edhe gjëja që është vënë në dijeni dhe është thirrur për këtë pjesë dhe zotëria që ka parcelë jam ulur dhe kam folur dhe unë problemin e kam me bashkinë ka thënë, ajo është pronë e imja dua e mbyll dua e hap me letra . Se si i ka letrat unë nuk jam jurist për ta verifikuar por zotëria është i gatshëm të bashkëpunojë me bashkinë Rrogozhinë për të ...

Mukades Gixhari . Z. Indrit ta dëgjojmë.

Enver Memolla . Zotëria është gati për bashkëpunim.

Silvana Aliu . Nuk mund të lihen banorët dhe zotëria në konflikt sa të presim ne sa bashkia të mbarojë , ne marrim vendim derisa bashkia të bashkëpunojë me atë dhe rruga të rrijë hapur nuk ka asgjë.

Enver Memolla . Vendimin ta solli Prefekti.

Silvana Aliu . E marrim ne.

Enver Memolla . Po e morëm.

Alime Hoxha . Është e pavlefshme.

Mukades Gixhari . Vendimet tona shkojnë në Prefekturë nuk i marrim do dhe t'i zbatojmë.

Enver Memolla . Dhe unë po them bëhet fjalë për tokën me gjyq të fituar nga zotëria dhe nuk është likuiduar nga Bashkia e Rrogozhinës.



Shpati Kolgega . Më fal ai ka fituar gjyqin?

Enver Memolla . Ai ka fituar gjyqin për një pronë tjetër për dëmshpërblim.

Shpati Kolgega . Tjetër jo që ka lidhje me rrugën.

Enver Memolla . Kurse në negociata ka qenë bashkia që tokën të ja shesë bashkisë Rrogozhinë për projekt urban që të bëhet dhe rruga sipas personit që kam folur.

Silvana Aliu . Sipas premtimit që u bë , që do bëhet kënd lojërash dhe gjithë mbeturinat e rrugës janë hedhur aty.

Enver Memolla . Ne vendimin e morëm Prefekti thotë është i paligjshëm tani nëse kjo shkresë që ka ardhur tani këtu thotë bashkia në bazë të kësaj shkrese ngrejmë grupin e punës verifikon metrat që janë për të ngritur dhe ta bëjë në terren pastaj.

Shpati Kolgega . Atëherë grupi i punës që ishte ngritur duhet të vijë të raportojë apo të japë zgjidhje situatës, në qoftë se kryetari ka ngritur një grup pune sipas shkreës që pashë.. grupi në datë 5 Mars ishte ngritur pra dy javë ka.

Hekuran Xhani . Kryetari ka nxjerrë një urdhër të brendshëm për ekzekutimin e vendimit që morëm ne me nr.83, datë 5.3.2025. Ne nuk kemi këtu as proceverbal as të paktën ai kryetari i këtij grupit duhet të vijë sepse faktikisht neni 265 i kodit të procedurës civile përcakton qartë në moment që ka konflikte civile apo rruge në moment që futesh në gjykatë asnjë organ tjetër nuk mund të marrë vendim mbi gjykatë. Ne tani të na sjellë informacion ai që është kryetar i këtij grupit të punës të na sjellë informacion deri ku ka shkuar bashkia, se nuk mund të marrim vendim për mbi vendim. Le ta lejmë kështu të marrim informacion nga bashkia ne patjetër nuk mund të marrim vendim mbi vendim se prap do na kthehet vendimi mbrapsht të jesh i bindur . Se dhe unë kam pasur një rast e mori kryetari atë dhe e rrëzoi Prefektura .

Indrit Dedej . Po nuk funksionuan komisionet kot bëjmë mbledhje këshilli.

Enver Memolla . Unë e kam thënë dhe herë tjetër kur kam qenë kryetar grupi për mbledhjet e komisioneve këto debate që zhvillohen këtu zhvillohen në komision vjen kryetari i komisionit bën relacionin ose e bllokun ose jo nuk mund të bëjmë tani çdo mbledhje të njëjtën gjë punën e komisionit.



Hekuran Xhani . Ver ke shumë të drejtë por kur nuk ka një përfaqësues të lartë të administratës së bashkisë nënkryetari ose kryetari të paktën duhet të jenë sepse ne e marrim një informacion të ishte nënkryetari deri ku ka shkuar kjo punë. Kështu që kryetare të tërheq vëmendjen para se të njoftosh këshilltarët do njoftohet kryetari është s'është i ngarkuar është punët e veta, të paktën një nënkryetar duhet të jetë që ta dimë dhe ne deri ku ka shkuar zgjidhja e atij konflikti që faktikisht siç thotë Indriti është konflikt me pasojë atje larg qoftë nëse atje mund të ketë dhe incidente.

Mukades Gixhari . Për mbledhjen e këshillit kur vendosim ditën lidhemi me Kryetarin e Bashkisë, çdo mbledhje pastaj vendosim ditën me kryetarët e grupeve kështu funksionon dmth ato janë në dijeni .

Indrit Dedej . Sa kohë ke që nuk e takon kryetarin e bashkisë?

Mukades Gixhari . Ç'rëndësi ka. Para një jave jam takuar me kryetarin.Me kryetarin unë flas çdo mbledhje përpara, siç kemi folur bashkë kur ishte kryetar unë e di si funksionon.

Indrit Dedej . Po pra në momentin që nuk ke pasur kontakte me atë, është inekzistent kryetari i bashkisë.

Mukades Gixhari . Kush tha që nuk kam pasur, para një jave jam takuar, para 5 ditësh kam folur në telefon për mbledhjen.

Indrit Dedej . Kryetare ka një vit kryetari i Bashkisë që nuk vjen në mbledhje, ka ardhur vetëm për buxhetin në Dhjetor , kemi 3 muaj e ke parë kryetarin këtu ti? As kryetarin as nënkryetarin dmth nuk funksionon bashkia e kupton?

Silvana Aliu . Aty është një pikë në fund nëse ne kemi kërkesa kujt t'i drejtohem .

Indrit Dedej . Ti je e zgjedhur këtu për interesat e komunitetit dhe duhet t'i kërkesha llogari se ne për të kërkuar llogari jemi, si bëjmë fresk asnjërit.

Silvana Aliu . Atëherë nëse ky konflikt nuk merret nga Bashkia pse policia ja kërkoi këshillit bashkiak?

Enver Memolla . Unë kam folur drejtpërdrejt me personin sot dhe fjalët që kam thënë dhe fjalët që po them po i thme me dijeninë e personit që do i them në këshill bashkiak. Rruga është e



hapur si më ka thënë se unë nuk kam qenë në terren kalojnë në këmbë me makinë nuk kalojnë dhe tha unë po pres deri nesër çfarë përgjigje do vijë nga Bashkia Rrogozhinë kam thirrur drejtorin që është me leje e kam takuar jam ulur dhe unë pres përgjigje ... sepse dhe zotëria ka marrë dijeni që këshilli bashkiak ka marrë vendim, e ganuar se është pronë private dhe thotë ti si këshill bashkia çfarë vendimi merr për pronën time. Këshilli Bashkiak është pronar i bashkisë . Kur më tha që ka ardhur kjo shkresa i thashë të shohim cila kordinatë është rruga dhe pjesa që është shtetdhe këtë po vlerëson komisioni që është ngritur. Ka dalë një parcelë tokë shtet . Indrit e dimë që është problem madhor e thashë dhe radhën e kaluar.

Shpati Kolgega . Policia çfarë bën në këtë rast nëse çohet dikush bllokun atë që nuk e ka tokën e vet?

Enver Memolla . Ai kërkon dy gjëra për marrjen e dëmshpërblimit dhe marrëveshjen që është bërë lart .

Shpati Kolgega . Ver dëmshpërblimin ai ta kërkojë tek toka që ka nuk lidhje këtu për një tokë tjetër.

Enver Memolla . Unë kam dalur garant që ta ul me kryetarin e bashkisë, uluni diskutoheni i thashë se është problem madhor nuk është problem që ka zënë kanal. Hekuran nëse do kishte vullnet ajo gjë do kishte mbaruar me kohë sepse thashë që ka rënë dakord që pronën të ja shesë bashkisë Rrogozhinë me çmim referencë që ka kadastra lart ai e kambyllur çështjen e vet. Unë ndaj thashë që ne këtu duhet ti themi bashkisë do ta marrësh këtë pronë ta bësh çfarë ke premtuar dhe servitutit si duhet të kalojë rruga . Kjo është zgjidhja, duhet të bëjë plan urbanistik bashkia ta marri se është 1800 m² tokë nuk është 100 m dhe e merr me ligj është plan publik ai prish shtëpinë me plan publik.

Mukades Gixhari . Z. Ismail Broli do na relatojë tani.

Ismail Broli . Në bashki dhe në këshill dhe nëpërmjet platformës na kanë ardhur shumë ankesa që të jeni në dijeni në lidhje me këtë problematikë pra për rrugën dhe ne si drejtori bashkë me sektorin e kadastrës kemi bërë një aplikim në hipotekë për statusin juridik të kësaj prone pra vetëm pjesën e rrugës. Dhe na ka ardhur përgjigja nga hipoteka që thotë është pronë shtet është kartela e pasurisë ku citohet , bëhet fjalë për numrin e pasurisë 206/66 sipërfaqe totale 132 m, ku është rruga nga hyrja deri ku merr kthesënpak a shumë dhe është pronë shtet , ne shkuam këtë javë të Hënën a të Martën nuk e mbaj mend fiks shkuam dhe bëmë një verifikim vetë në terren si specialistë të urbanistikës dhe ç'është e vërteta aty gjetëm disa pengesa të tipit shkurre gurë



ndoshta e keni parë ndokush nga ju . Dhe veprimi që diskutuam ishte që t'i bënim një memo të dy zyra drejtorisë së shërbimeve dhe policisë bashkiake që të impenjoheshin me stafet e tyre në mënyrë që të largonim pengesat dhe të ishte kjo pronë shtet dmth e pa uzurpuar sepse duke qenë se është shtet nuk askush të drejtë ta cënojë ta uzurpojë apo të fusë pengesa . Gjithashtu nuk u shpreha por i është nisur dhe shkresa drejtorisë vendore të policisë së shtetit Kavajë ku i kemi thënë janë organet kompetente që duhet të merren me ruajtjen e pronës publike pra qoftë policia bashkiake qoftë policia e shtetit, kjo është gjithë procedura që kemi ndjekur këtë javë.

Enver Memolla . Ky është një konflikt që ka gati 5-vite mbyll e hap. Kur është bërë kjo kërkesa që kadastra ka sjellë përgjigje para një jave kur ka ardhur?Se ky konflikt ka qenë i mbartur me kohë, bashkia kur ja ka nisur? Palët konfliktuese duhen vënë në dijeni për shkresën që ka ardhur apo jo?

Ismail Broli . Po patjetër, gjithë këtë praktikë e kemi bërë këtë javë.

Fatmira Thartori . Nga dita e Hënë sot është e Enjte, çfarë ka bërë bashkia pra policia bashkiake në këtë periudhë? Po pse cila është arsyeja për çfarë shërben policia bashkiake?

Ismail Broli . Janë protokolluar shkresat janë shpërndarë cikluar normalisht duan...

Fatmira Thartori . Brenda sa afatesh kohore?

Ismail Broli . Po minimalisht ciklimi protokollimi shkresat 5 ditë.

Fatmira Thartori . 5 ditë? Po ai sherr atje ka 5 vjet.

Hekuran Xhani . Personi që është pretendues në konflikt sot ka ardhur nga hipoteka që është pronë shtet është kontaktuar? Sepse mund të ketë dhe mbivendosje dhe të vazhdojë konflikti prap.

Ismail Broli . Mbivendosje të tipit?

Hekuran Xhani . Të tipit që ky burri mund të ketë certifikatë pronësie, ti ke shkuar tek hipoteka ta ka dhënë pronë shtet...

Ismail Broli . Nuk ndodh është një supozim që nuk ka pasur.



Hekuran Xhani . Ky personi që ka zënë rrugën pretendon që e ka tokën e vet...

Ismail Broli . Pretendimet mund të jenë të shumëllojshme, ideja është sa baza kanë këto pretendime?

Hekuran Xhani . Atje duhet të shkojë bashkia , personat që pretendojnë për hapjen e rrugës dhe personi që pretendon kjo është prona ime vetëm kështu mund të zgjidhet ky problem , pra aty janë tre palë pushteti edhe palët në konflikt edhe të mbyllet një herë e mirë, në rast se ju shkoni e hapni rrugën 1 javë ai shkon nëpër gjykata thotë është prona ime.

Ismail Broli . Të drejtën për gjykatë nuk ja ndalon askush ideja është sa bazë ka ai që ta çojë në gjykatë në gjykate nuk e frenojmë as ne as ju .

Hekuran Xhani . Ai mund të ketë marrë një certifikatë po nga komisioni i ndarjes së tokës në Rrogozhinë me ligjin 7501.

Ismail Broli . Shumë mirë, ka një historik që e ka marrë dikur mund të ketë bërë veprime mund të mos ketë bërë dhe ne marrim gjithmonë veprimin e fundit që është kjo pasuri është regjistruar në pronë shtet me këtë numër pasurie me këtë zonë kadastrale dhe sipërfaqe dhe çdo gjë që ka ndodhur jashtë kësaj është histori .

Hekuran Xhani . 5 vjet konflikt kështu siç e raporton ti sot paska qenë e thjeshtë.

Ismail Broli . Ne i kemi futur në protokoll janë të gjitha në protokoll edhe policisë.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Ismail. Atëherë para se të kalojmë në rendin e ditës ju kam dërguar në grupin e Këshilltarëve në WhatsApp Planin Operacional Vjetor 2025-2026 Për administrimin e pyjeve dhe kullotave të bashkisë Rrogozhinë. Kërkesa nga qytetarët znj. Gentiana Uka dhe z. Nazmi Saraçi, kemi dhe Planin e Punës për pastrimin e kanaleve të dyta për muajin Mars - Prill 2025, në fakt kjo është kërkesë e drejtuar nga Këshilltari z. Enver Memolla. Jeni dakord t'i përfshijmë në rend dite këto materiale dhe ti shqyrtojmë në pikën të ndryshme të rendit të ditës?

Hekuran Xhani . Meqë ky është një problem emergjent për çështjen e sektorit të bujqësisë unë them nuk ka asnjë problem ta kalojmë.

Mukades Gixhari . Atëherë janë këto pika. Jeni dakord t'i kalojmë në rendin e ditës? E hedhim



në votim. Vota pro, kundër, abstenim? Më fal pro t'i numërojmë se...Atëherë të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 16-vota pro përfshirja në rendin e ditës e materialeve :

“Plani Operacional Vjetor 2025-2026 Për administrimin e pyjeve dhe kullotave të bashkisë Rrogozhinë”.

Kërkesa nga qytetarët znj. Gentiana Uka dhe z. Nazmi Saraçi.

Plani i Punës për pastrimin e kanaleve të dyta për muajin Mars - Prill 2025.

Mukades Gixhari . Kemi miratimin e rendit të ditës.

-Largohet jashtë sallës së mbledhjes këshilltari z. Hekuran Xhani. (27 min ; 40 sek zhvillimi i mbledhjes).

Jeni dakord për miratimin e rendit të ditës. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 15-vota pro, pika e parë e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Miratim i procesverbalit Nr.2, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 24.02.2025. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 15-vota pro, pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kemi pikën 3, Shqyrtim i vlefshmërisë së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak z. Isa Halili. Tani kush e do fjalën nga komisioni i mandateve? Po znj. Silvana.

Silvana Aliu . Atëherë duke qenë se duhet të respektohet deri në fund që personi do të vijë të flasë vetë nga pamundësia që nuk mund të vinte i kërkoj edhe njëherë kryetarit që ta kalojmë për mbledhjen që vjen.

Shpati Kolgega . Po tani, ai ka hall dhe nuk vjen ...

Silvana Aliu . Është nisur...

Shpati Kolgega . Përfundimi do jetë i njëjtë...



Silvana Aliu . Nejse ne i japim mundësinë,

Shpati Kolgega . Pavarësisht e dëgjojmë se dëgjojmë ne e dëgjuam në fakt kur ishim herën e fundit dy ose tre mbledhje përpara ne e dëgjuam edhe...

Alime Hoxha . Provat kanë ardhur nga KQZ-ja. E respektojmë por kemi tre mbledhje rreshtë që po e respektojmë.

Mukades Gixhari . Jeni dakord që ta shtyjme në mbledhjen e radhës? E hedhim në votim.

Shpati Kolgega . Më shumë për të mos ju dalur kundra juve meqë doni ta shtyni .

Mukades Gixhari . Atëherë dakord jeni të gjithë pro. Shtyhet për mbledhjen e radhës.

-Miratohet me 15-vota pro, shtyrja për shqyrtim në mbledhjen e radhës të pikës nr.3, të rendit të ditës .

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës,

Shpati Kolgega . Dëgjo do ju tolerojmë dhe këtë rherë grupin opozitar se ju vetë e sollët rastin tani doni ta shtyni. Të jemi seriozë ju e sollët rastin e çuat atje ku e çuat, u vërtetua që ishte ashtu, tani doni ta shtyni , tani edhe ju bëhuni pak seriozë. Po ju tolerojmë dhe këtë herë pastaj herës tjetër nuk ka më shtyrje.

Mukades Gixhari . Viojmë me mbledhjen me pikën 5, me pikën 4 ndjesë, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”. Relaton drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani. Përshëndetje z.Ledian.

Ledian Hasani . Përshëndetje të gjithëve si jeni? Gjithsej janë 12-familje përfituese dhe fondi është 45 mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . Materialet i keni përpara i keni parë ndonjë pyetje për ndihmën 6%? Në qoftë se nuk ka e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim pika 4 (katër) e rendit të ditës.



Vendim nr.8. Miratohet me 15-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.1083.Prot datë 11.03.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2025 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6%”, si dhe Relacioni Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.1083/1.Prot datë 11.03.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 5, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2025 nga fondi i pushtetit vendor”.Vazhdojmë po me z. Ledian.

Ledian Hasani . Në total janë 22 familje që janë përfituese dhe fondi është 100- mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . Pyetje rreth kësaj pike, diskutim? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim pika 5 (pesë) e rendit të ditës.

Vendim nr.9. Miratohet me 15-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë me shkresë Nr.1084.Prot datë 11.03.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2025 nga fondi i pushtetit vendor”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.1084/1.Prot datë 11.03.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 6-të, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë”. Vazhdojmë me z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Atëherë është një familje që jeton në fshatin Demarkaj, është në varfëri ekstreme është familje që trajtohet me ndihmë ekonomike, zotëria dhe ai vetë nuk është se ishte shumë në terezi por dhe gjendjen familjare e kishte fëmijën e ka të sëmurë plus që dhe nusen e kishte të sëmurë , familja është prej 4 anëtarësh është dhe i pastrehë se i është dëmtuar shtëpia nga tërmeti është DS5 , DS4. Ne vetëm verifikojmë gjendjen social ekonomike , çfarë gjendje është shtëpia jetohet a nuk jetohet pastaj pjesa tjetër .

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje tjetër në lidhje me këtë pikë sugjerim? Po znj. Alime. Pyetje tjetër? Atëherë e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim pika 6 (gjashtë) e rendit të ditës.



Vendim nr.10. Miratohet me 15-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.1085.Prot datë 11.03.2025 “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë”, si dhe Relacionin Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.1085/1.Prot datë 11.03.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 7-të, Miratim i projekt - vendimit, “Për vlerësimin e aplikantëve për përfitimin nga programi ‘Subvencionimi i Interesave të Kredisë për vitin 2025’”. Vazhdojmë po me drejtorin e mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani.

-Rikthehet në sallën e mbledhjes këshilltari z. Hekuran Xhani në minutën e 34 të zhvillimit të mbledhjes.

Ledian Hasani . Atëherë siç keni dhe dokumentet përpara gjithsej janë 8-të përfitues , ne kemi akoma kuota të lira sepse janë kuota që ministria na ka sjellë shkresë që edhe ato kuota që janë të lira nga viti 2019 deri në 2025 mund t’i përdorim për qytetarët që janë të pastrehë. Kështu që kemi akoma kuota të lira në një moment tjetër do ta hapim prap si program. Atëherë momentalisht unë kam të lira 9-kuota pastaj dhe ato që kanë kaluar në këshill dhe nuk kanë marrë kredi tek banka këto mund t’i përdorim përsëri i kam çuar shkresë bankave dhe po pres përgjigje kush e ka marrë kredinë kush nuk e ka marrë.

Alime Hoxha . Sa kërkesa kanë ardhur?

Ledian Hasani . Atëherë kanë qenë 15 kërkesa .

Alime Hoxha . Kanë përfituar 8-të.

Ledian Hasani . Disa nuk kanë pasur dokumentacionin janë skualifikuar.

Alime Hoxha . Janë vënë në dijeni?

Ledian Hasani . Janë vënë në dijeni si jo, dy janë tërhequr i bie dhe 5 të tjerë nuk kanë plotësuar dokumentacionin.

Alime Hoxha . Keni lënë një afat për tëq plotësuar dokumentacionin.

Ledian Hasani . Po kemi lënë, shiko ato kanë mundësi për herën tjetër, jo vitin tjetër do hapet prap kismet këtë vit sepse janë 9-kuota të lira që do përdoren .



Enver Memolla . Sa për informacion kam dy ankesa për këtë pjesë, aplikimi është bërë tek e-albania por nuk kanë çuar dokumentacionin në bashki dhe i bie që janë të detyruar që pasi bëjnë aplikimin tek e-albania duhet ta sjellin dokumentacionin ? Shkruaje këtë pjesë se janë të painformuar presin tek e-albania, është pika e parë tek e-albania hapi i dytë është procesi për t'i çuar.

Ledian Hasani . Unë nuk kam informacion nga e-albania ne e kemi nxjerrë tek faqja e bashkisë. Ka persona që kanë aplikuar dhe nuk na i kanë sjellë ne dokumentacionin. Nëse ato do të na i sillnin para se të bëhej projektvendimi normalisht që do i kalonim sepse ka kuota të lira nuk është se keni më shumë kërkesa se sa kuota, kemi kuota më shumë se sa kërkesa. Edhe për një person që pretendon ai që nuk na ... ne prap do ta kalonim kishim vende të lira , po ta shikoni në fund të relacionit unë e kam sqaruar. Janë njoftuar tek faqja e bashkisë tek faqja e kryetarit të bashkisë është hedhur sistemi i pikëzimit që kaluam bashkërisht në këshill. Po këto që aplikuan si e morën vesh që aty bëhej një program strehimi?

Indrit Dedej . Z. Ledian prej sa vetash bëhet komisioni juaj?

Ledian Hasani . 7-persona.

Indrit Dedej . Si e keni ju opozitë mazhorancë apo ...

Ledian Hasani . Nuk ka lidhje.

Indrit Dedej . Këtu shoh 4 firma, 3 të tjerët...

Ledian Hasani . Atëherë komisioni ... janë 5 firma dy firma njëri ka qenë me leje tjetri ka pasur punët e veta , komisioni kalon me 4 firma që ta dini.

Indrit Dedej . Thjeshtë për ta ditur.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim.

Silvana Aliu . Edhe pse nuk është dhënë në mënyrë të drejtë e hedhim.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim pika 7 (shtatë) e rendit të ditës.



Vendim nr.11. Miratohet me 16-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.1125.Prot datë. 13.03.2025 “ Për miratimin e aplikantëve për përfitimin nga programi ‘Subvencionimi i Interesave të Kredisë për vitin 2025’ “ si dhe Relacioni shpjegues për këtë projektvendim me Nr.1125/1.Prot datë 13.03.2025.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Ledian, jemi tek pika 8 të, Informim i Këshillit mbi , “Parandalimin e dhunës me bazë gjinore”. Relaton koordinatoreja e dhunës në familje znj. Anxhela Hoxha. Përshëndetje znj. Anxhela fjala për ju.

Anxhela Hoxha . Përshëndetje të gjithëve! Atëherë doja të ju informoja mbi dhunën në familje përgjatë vitit 2024 ne kemi pasur gjithsej 30 raste ku 15 prej tyre kanë qenë me urdhër mbrojtje dhe 15 janë mbyllur në postën e policisë ku kanë rënë dakord me njëri tjetrin. Ne gjithmonë asistojmë në postën e policisë shikojmë gjendjen marrim masa me grupin e dhunës ndihmojmë nëse kanë nevojë për ndihmë juridike dhe psikologjike dhunuara pastaj në bazë të vendimit të gjykatës ne menaxhojmë rastin. Kemi ofruar strehim social për të dhunuarën që ka pasur nevojëpor deri më tani kanë refuzuar. Aktualisht janë 6 me urdhër mbrojtje.

Indrit Dedej . Ka pasur raste që me vendim gjykate kanë marrë urdhër mbrojtje dhe kanë fjetur bashkë në një dyshek?

Silvana Aliu . Në momentin që dhunohet nuk mund të rrinë të dy në një banesë.

Shpati Kolgega . A ka kushte bashkia po të përgjigjet që a ka kushte bashkia që ta ndjeki rastin që ta ndihmojë që të strehohet e tjera me radhë.

Anxhela Hoxha . Atëherë ne si bashki nuk kemi një strehim social por bashkëpunojmë me organizatat. Po bashkëpunojmë me organizatat të cilat janë në Tiranënëse e dhunuara ndjehet në rrezik për jetën ne flasim me organizatën dhe marrim masa që të strehohet atje bashkë me fëmijën nëse ka fëmijë dhe vazhdojnë kanë rregullat e veta që fëmijët vazhdojnë shkollën e dhunuara është e sigurtë. Unë flas për periudhën që kam qenë unë.

Mukades Gixhari . Atëherë nëse nuk ka diskutim tjetër? Faleminderit. Kemi tani pikën 9-të, Shqyrtim i problematikës së ndërprerjes së energjisë elektrike në Bashkinë Rrogozhinë. Ju jeni të gjithë në dijeni që në muajin Shkurt ne i dërguam një kërkesë OSHE-së në Durrës që ato të vinin dhe na sollën një kthim përgjigje që kërkesa juaj na ka ardhur ditën e mbledhjes dhe këtë radhë jakemi dërguar shumë shpejt që atyre të mos i shkonte ditën e mbledhjes por nuk kemi asnjë përgjigje ndonjë konfirmim që ato do vijnë. Tani kalojmë tek pika 10 që janë të ndryshmet. E



fillojmë me Planin Operacional Vjetor 2025-2026 Për administrimin e pyjeve dhe kullotave të bashkisë Rrogozhinë. Kemi z. Artur Kaja që do na raportojë.

Artur Kaja . Përsëritet të gjithëve ! Do kërkoja në radhë të parë mirëkuptimin tuaj për mënyrën e të folurit pasi kam pasur një ndërhyrje kirurgjikale në fytyrë dhe duhet të kem të folurët sa më të pakët sipas doktorit derisa të shërohem por sidoqoftë... Atëherë plani operacional vjetor Në zbatim të nenit 11, pika 2/c 'Përgjegjësitë e strukturave vendore përgjegjëse për pyjet" i Ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet" , Sektori i Pyjeve në Bashkinë Rrogozhinë e vlerësoi këtë problem me seriozitetin e duhur dhe me angazhimin maksimal duke hartuar këtë Plan Operacional Vjetor. Konkretisht synohet në:

1. Mirë administrimin dhe përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të pyjeve dhe kullotave dhe të burimeve natyrore, në territorin administrativ të Bashkisë Rrogozhinë.
2. Shfrytëzimin e të gjitha resurseve dhe potencialeve që ka fondi pyjor.
3. Krijimin e traditës si dhe përmirësimin e praktikave të trajnimit të pyllit bashkiak, shfrytëzimit sa më racional të kullotave, prodhimeve pyjore drusore, jo drusore, grumbullimin e bimëve medicinale, tanifere e eterovajore, sipas rregullave dhe kërkesave teknike brenda mundësive të tyre të shfrytëzimit.

Ky plan ka për qëllim rritjen e gjenerimit të të ardhurave , nga burimet natyrore , zhvillimin e tyre në shërbim të komunitetit dhe detajimin e investimeve për zhvillimin e tyre të mëtejshëm. Planin vjetor operacional është përmbledhës i mundësive konkrete të burimeve, kapaciteteve realizuese e menaxhuese, mundësive financiare , që do të bëhen e arrihen për një periudhë të caktuar kohore 1 (një) vjeçare.

Planin është i fiksuar në dy aspekte kryesore:

1. Burimin e të ardhurave për komunitetin (përdoruesit), që ndikon në rritjen e të ardhurave dhe në përmirësimin e jetesës së tyre.
2. Mundësinë e daljes në treg me prodhime të tjera që mund të shiten duke krijuar të ardhura për Bashkinë Rrogozhinë.

Qëllimi i Planit Operacional.

Në përpilimin e këtij plani operacional si qëllim kemi patur që nëpërmjet investimeve në fondin pyjor bashkiak të sigurohet një pyll sa më i pastër duke i dhënë përparësi drurëve me vlerë, drurëve mbizotërues duke hequr drurët e shtrembër, të tharë, të semurë etj. Kjo do të arrihet duke hequr deri në 25 % të numrit të drurëve.

Është patur parasysh se nëpërmjet të ardhurave që do të krijohen një pjesë e mirë e tyre do të kalojnë në investime dhe duke patur investime kemi dhe fuqi punëtore të zënë me punë , të ardhura për to dhe ngritjen e mirëqënies për komunitetin.

Bashkia Rrogozhinë, Sektori i Pyjeve, shoqatat e përdoruesve të pyjeve, si dhe komuniteti do të jenë shumë të angazhuar për këtë problem në mënyrë që ky plan vjetor operacional të gjejë



zbatim konkret në terren. Komuniteti nga ana e tij është i interesuar për mirëmenaxhimin e fondit pyjor bashkiak, për investime direkte në pyje dhe kullota, me punësimin e tyre, që të krijohet një pyll model në mënyrë që të synohet rritja e prodhimit dhe rritja e mirëqënies së komunitetit nëpërmjet të ardhurave që fitojnë nga puna e tyre. Kjo do të arrihet me takime direkte me komunitetin e fshatrave të Njësive Administrative ku ndodhen këto pyje.

Në hartimin e këtij plani dalin dhe detyra që do të shqyrtojmë më poshtë ku për çdo punë të planifikuar do të hartohen projektet përkatëse dhe zbatimi i tyre do të bëhet nëpërmjet procedurave të konkurimit sipas udhëzimeve përkatëse.

Burimet financiare do të sigurohen nga të ardhurat që dalin nga prodhimet pyjore e jo pyjore, prodhimet e dyta pyjore, bimëve mjekësore etrovajore e tanifere si dhe nga resurset e tjera të fondit pyjor dhe kulloror.

Gjithashtu me investimet që do të planifikohen do bashkëpunohet ngushtë me projektin e pyjeve në Ministrinë e Mjedisit, Projektin e Bankës Botërore, Projektin e zhvillimeve mjedisore si dhe me shoqata të tjera mjedisore.

Plani në realizimin e tij do të kalojë në disa etapa kryesore:

- Faza përgatitore
- Grumbullimi i të dhënave duke përfshirë edhe vëzhgimet në terren.
- Analizen e të dhënave
- Hartimi dhe përpilimi i Planit Operacional.

Për të realizuar këto etapa është e domosdoshme që të bëhet një analize e përgjithshme social-ekonomike për Bashkinë Rrogozhinë dhe Njësive Administrative që e përbejnë këtë Bashki.

Përdorimi aktual i pyjeve, kullotave dhe burimeve natyrore.

Pyjet dhe kullotat e Bashkisë Rrogozhinë zënë një sipërfaqe prej 3135 ha nga të cilat 2213 ha pyje, 209 ha sipërfaqe me bimësi pyjore, 29 ha sipërfaqe inproduktive dhe 922 ha kullota të cilat kanë kaluar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në Administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/ Bashkive. Burimet kryesore të të ardhurave janë : ...

-znj. Fatmira Thartori merr fjalën por që për shkak të distancës me laptopin që regjistron mbledhjen fjala e saj nuk dëgjohet.

Artur Kaja . Mos ngatërrojmë planin operacional ky plan nuk ka të bëjë as me dhënien me qera, se dhënia me qera është një projekt tjetër projekt që do kalojë në projektvendim por për momentin ... Atëherë në Njësine Administrative Sinaballaj prej vitesh ekziston shoqata e pyjeve dhe përdoruesve e pyjeve komunalë, yjet janë të shpërndara sipas fiseve dhe familjeve në bazë të fshatit, janë hartuar planë dhe projekte për këtë banorët janë të interesuar sepse secili banor



ose secili fis ruan pyjet e veta mos i dëmtohen nga të tjerët dhe grumbullojnë prodhime të dyta për t'i shitur dhe nuk flasin për t'i dhënë të tjerëve investitorëve apo flasim vetëm për pyjet komunale.

Altin Tosku . Më fal Turo ku ka pyje në Sinaballaj?

Artur Kaja . Atëherë në 2008 është hartuar një plan menaxhimi nga...

Altin Tosku . Jemi 2025 sot.

Artur Kaja . Tani pyje po futen dhe shkurret.

Fatmira Thartori . Ne përfaqësojmë çdo njëri nga ne përfaqëson një komunitet dhe ne nuk jemi të interesuar të investojnë të tjerë jemi të interesuar të investojnë vetë qytetarët. I kanë mbjellë t'i bëjnë me letra t'i bëjnë me dokumenta ta gëzojë pasardhësi i tij, kjo na intereson.

Artur Kaja . Po e përsëris përsëri nuk ka të bëjë me investime nga të tjerët , ky është plan operacional nuk ka të bëjë më investime nga të huajt ose nga banorët e tjerë.

Hekuran Xhani . Ne kemi sipërfaqe që sot bashkia i ka në inventar kullota ose pyje me shkurre faktikisht dhe realisht ato janë mbjellur ullinj nga qytetarët e bashkisë Rrogozhinë dikush ka 200 dikush ka 300. Në komunën Lekaj mesa di unë atje janë mbjellur pothuajse në ish pronat e vjetra pra janë mbjellur ullinj pa pasur konflikte njëri me tjetrin për sipërfaqet e mbjella pra e kemi shumë të lehtë si pushtet vendor ne ta menaxhojmë këtë pasuri sepse ulliri është bimë shekullore nuk është bimë që bëhet investim si kumbulla apo ..., edhe ne t'i regjistrojmë këto . Ta dijë dhe bashkia sa gjendje ka ullinj sot si pasuri edhe t'i pajisë qytetarët me një certifikatë pronësie në rast se është e mundur sepse janë sipërfaqe të mbjella apo të zëna në bazë të ligjit por pa konflikte. Edhe kodi i procedurës civile thotë një tokë një pronë që t'i e disponon 13 vjet pa konflikte automatikisht vitin e 14 ti je pronar i asaj toke sepse toka fitohet me trashëgim me dhurim por dhe një është forma e zabitimit. Kështu që ato e kanë zaptuar konflikte nuk kanë ne të regjistrojmë edhe rritet si pasuri edhe ai plani i pyjores ulet tashi edhe dihet që mos shkojmë diku se do vijë diku një investitor strategjik sepse këto po ja nxjerrin sytë popullit edhe Shqipërisë edhe thotë unë e kam marrë në Tiranë dhe thotë unë nuk e dua ullinj por e dua rrush sepse unë e kam marrë atje dhe kur të fillojnë qytetarët gjyqin pastaj pale prap qytetari përballë këtyre lloj investitorësh është i pafuqishëm. Pandaj le të fillojmë procedurat e para regjistrimin sepse ky nuk është problem për një familje ky është ku shumica e zonave tona kodrat e Kryeluzaj e deri në



Sinaballaj dhe Kryevidhit e të gjitha janë të mbjella, që t'i shkarkojmë nga plani pyjoes e të ja japim qytetarit mundësisht edhe me certifikatë pronësie.

Artur Kaja . Mos ngatërrojmë pyjet që janë pronë shtetërore që janë transferuar me vendimin nr.433 nga Ministria e Mjedisit me pyjet që janë krijuar pas viteve 90 në tokat ish produktive apo ullishtat apo çfarë kanë qenë vreshta sepse këto pyje nuk janë pyje këto janë pyje që kanë dalë në toka produktive apo kullota apo vreshta dhe si të tilla nuk përfshihen në fondin pyjor. Atëherë në komunën Lekaj vetëm në Kryeluzaj është një parcelë me pisha që ju e dini rrugës pastaj vazhdojnë pyjet në Mushnikë dhe Zanbishë e Levonaj pyjet e pishës. Thashë ka pyje gjithë e shikojnë që ka pyje por janë krijuar pyje në tokat inproduktive në vreshta ose ato tokat që janë dhënë kanë qenë pemtore janë krijuar duke u pre atëherë pemët e vreshtat dolën pyje edhe ato nuk janë pyje të regjistruara dhe unë nuk mund ta regjistroj pyll atë kur në zërin kadastral ajo është pemtore ose është ullishte ose është kullotë kështu që këto pyje nuk janë me fondin pyjor. Ne nuk kemi pyje sipërfaqe që janë zënë nga fshatarët për mbjellje ullinjsh .

Hekuran Xhani . Pra për njësinë Lekaj përveç sipërfaqes me pisha dhe të pjesës Zanbishë sipër nuk ka pyje tjera?

Artur Kaja . Jo në fondin pyjor jo.

Hekuran Xhani . Po kjo si quhet kjo dhe kush i menaxhon?

Artur Kaja . Ato janë krijuar pyje pas viteve 1990 sepse lëvizjet e njerëzve etj, por në zërin kadastral është ullishte është pemtore vreshtë është kumbull ka qenë mbjellë me kumbulla se ju e dini shumë mirë pjesa e Mushnikës.

Hekuran Xhani . Pjesa e Levonjes po ka qenë qershi dhe kumbulla.

Artur Kaja . Po ato i përkasin futen në fondin e tokave bujqësore, kështu që i takon ministrisë së bujqësisë nuk i takon pyjeve pavarësisht se janë bërë pyje.

Hekuran Xhani . Këto sipërfaqe nuk janë transferuar?

Artur Kaja . Për t'i kaluar në pyje bëhet një vendim i këshillit bashkiak me i kaluar me vendim me ministër është rrugë e gjatë që duhet me ndryshuar zërin kadastral kështu që ne i kemi.

Hekuran Xhani . Tani lidhur me këtë që thua ti se unë kam punuar dhe në atë sistem dhe tani



kam një moshë që e njoh realitetin edhe ato jo e gjithë sipërfaqja nga Kryeluzaj e ç'janë Okshtun ku ndaheshim ne me kooperativën Gosë që ishte në atë kohë ka qenë toka të hapura dhe të mbjella ka pasur brenda këtyre parcelave flas për krahun këtej jo nga ana e rezervuarit. Dhe problemi qëndron si mund ta zgjidhim ne këtë se ti je specialisti...?

Artur Kaja . Unë jam për pyjet jo për bujqësinë.

Hekuran Xhani . Po të pyes si psecialist, si mund t'i japim zgjidhje si këshill bashkiak që të ja zgjidhim këtë problem qytetarëve, si mendon ti? Që t'i njohim se faktikisht ato janë pronarë por përderisa janë pa letra, si mund t'i shërbejmë ne qytetarëve tanë që t'i pajisim me certifikatë pronësie. Silvana unë flas për njësinë time administrative toka është mbjellë duke u bazuar në kufijtë e vjetër të ish pronarëve nuk ka pasur asnjë kufi gjithsekush ka shkuar dhe ka mbjellë ... tani aktualisht këto janë pronarë ka familje që...

Artur Kaja . Atëherë më fal Hekuran unë e kam bërë të qartë dhe mbledhje të tjera që kam pas kaluar nga Kryeluzaj në kufi me Sinaballajn në kufi me Karinën mund të jenë me qindra e mijëra hektarë tokë ullishte që janë mbjellë nga persona të ndryshëm kanë mbi 20-30 vjet që kanë mbjellë me sipërfaqe varion nga 1 dynym deri në 1 ha 5 ha sipas mundësisë që ato kanë pasur. Atëherë e kam diskutuar dhe herë tjera për t'i kaluar këto që këto persona të njihen të bëhen pronarë të këtyre pronave duhet të bëhet ky projekti studimit që ne e kemi paraqitur herët tjera që të miratohet në këshill të kalojë për konfirmim tek Prefekti pastaj të bëhen procedurat ligjore për t'i dhënë ktyre personave me kontratë qeraje që në qoftë se ka ullinj e merr për 99-vjetdhe ajo i njihet atij dhe bashkia merr të ardhurat e veta, është me hektarë sipërfaqe mbi 1 hektarë duhet si kriter dhe janë caktuar çmimet nga qeveria që është 600 mijë lekë hektari. Ligji ta njeh mbi 1 ha për ullishte dhe 0.5 ha për pemë frutore sepse ka dhe që kanë mbjellur kumbulla dhe mollëpor janë të përcaktuara edhe çmimet edhe madhësia e sipërfaqes që duhet të plotësojë. Ndërsa KLSH-ja dikur në 2013 që janë dhën disa sipërfaqe në përdorim 2 persona ë kishin marrë nga 0.8 ha ja quajti shkelje bashkisë, pse e ke lënë 0.8 kur është ligji për mbi 1 hektarë kurse për pemët frutore duhet 0.5 hektarë dhe çmimet ndryshojnë për ullistet çmim tjetër për pemëtoret çmim tjetër.

Hekuran Xhani . Bashkia Rrogozhinë e ka këtë projekt studimi?

Artur Kaja . Ne e kemi paraqitur disa herë por na është refuzuar se jo është toka kështu jo është me pretendime... Kjo është paraqitur tek projekti për dhënie me qira të tokave bujqësore, tokën bujqësore këtë vit u bënë debate janë ndarë nga toka pyjore , i kemi ndarë si projektvendime do sjellim prap të veçantë për pyjet dhe për bujqësinë që mos kemi përplasje pse pyjet pse ...



projektvendimin për bujqësinë ta mbrojë ai që është për bujqësinë për pyjet do ta mbroj unë. Për momentin ne nuk mund të paraqesim asnjërën as tjetrën se ligji për zgjedhjen nuk e lejon me e kaluar në këshill.

Hekuran Xhani . Ai projekt është.

Artur Kaja . Unë faktike e kam diskutuar dhe këtë por zyra juridike thotë që jo sespe ...

Hekuran Xhani . Po çfarë ka ne nuk do ndajmë toka.

Artur Kaja . Edhe unë me këtë mendim jam ky është një projektstudim që miratohet këtu do kalojë për konfirmim pastaj dhëniet me qira do vazhdojnë pas zgjedhjeve.

Mukades Gixhari . Fjala për z. Enver Memolla.

Enver Memolla . Kryetare faleminderit. Turi nuk e di a e dëgjova qartë por po thua që ka pyje që nga tokë ulla janë kthyr vetvetiu në pyje? Këto pyje nuk janë në pronësi të fondit pyjor? Ti po thua që ka toka bujqësore që janë pyje?

Artur Kaja . Janë krijuar pyje duke u lënë pa punuar.

Enver Memolla . Janë prerë ulla janë prerë kumbulla e fiq dhe kanë dalur pemë dhe është bërë pyll. Tani këtu duhet të ndajmë diçka pisha pyje apo shkurre se ke ardhur herë tjetër ke thënë shkurre ku është pyll është tokë bujqësore, pishë por është tokë bujqësore tani...

Artur Kaja . Si pishë tokë bujqësore?

Enver Memolla . Po sapo ma the që ka dalë pisha në tokë bujqësore.

Artur Kaja . Nuk del pisha në tokat bujqësore nuk del vetë.

Andi Proshka . Ka pyje që ka dhe shkurre ka dhe pemë ...

Artur Kaja . Ja bëra të qartë pylli nuk është vetëm ai me pisha, pylli ka dhe shkurre ka dhe me..

Enver Memolla . Të ndërpres prap po thua tokë bujqësore që ka dalë pisha dhe tokë bujqësore që ka dalë shkurre. Tani si do ta ndajmë shkurren është pyll?



Artur Kaja . Të thashë që në tokën bujqësore pas vitit 1990 që uë bënë prerje me ullishte në pemëtore etj filluan duke dalur shkurre edhe u krijuan pyje por këto nuk janë pyje që ne i kemi në administrim.

Enver Memolla . Pikërisht këtë po them janë pyje që ju nuk i keni në administrim por të kujt janë?

Artur Kaja . Është tokë bujqësore inproduktive i ka ministria e bujqësisë.

Alime Hoxha . Tani ju thoni që janë pyje që janë krijuar nga tokat që kanë qenë ullinj kanë qenë me pemë por këto toka janë në pronësi të dikujt se këto toka janë ndarë të gjitha?

Artur Kaja . Tokë bujqësore e shtetit.

-Largohet nga mbledhja pas 1 ore ; 08 min ; 25 sek të zhvillimit të saj këshilltari z. Sokol Gosa.

Hekuran Xhani . Jo e zyrës së bujqësisë së bashkisë.

Alime Hoxha . Po a janë ndarë këto toka? Ka pjesë tokash që nuk anë ndarë që kanë qenë pemtore?

Artur Kaja . Po.

Alime Hoxha . Dhe tani këto janë në pronësi të kujt? Po flasim tani për këto toka që janë mbjellur ullinj se në ato toka janë mbjellë në ato kodra që kanë qenë me pemë, po flasim për Sinaballaj këto toka që kanë qenë me pemë ju thoni janë në pronësi të ministrisë së bujqësisë. Ka dhe të tjerë që janë mbjellë ullinj a kanë këto mundësi që t'i marrin në pronësi këto toka?

Artur Kaja . Duhet me i kaluar në këshill t'i kalojë Prefekti.

Enver Memolla . Unë e kisha këtu nëse nesër unë interesohem për të marrë një tokë bujqësore që është me pisha, tokë pyll që është me shkurre.

Artur Kaja . Këtë pjesë duhet me ju drejtuar zyrës së bujqësisë .

Enver Memolla . Ka dalur dhe shkurrja pyll dhe shkurrja në bujqësi, po mirë sill një projekt të saktë...



Hekuran Xhani . Ta dimë sa kemi shkurre dhe pyje.

Enver Memolla . Edhe në mbledhjen e kaluar kam thënë bëj një inventarizim të parcelave që keni tokë bujqësore tokë pyjore tokë e zënë dhe silleni.

Hekuran Xhani . A ka cënim të sipërfaqes pyjore që bashkia Rrogozhinë disponon në zonën bregdetare? Pra a keni sipërfaqe të zabtuara nga pyjet që kanë administrim bashkia në zonën e bregdetit?

Artur Kaja . Personat përgjegjës në komuna bënë ndarjen ... këto u bënë objekt i hetimit të prokurorisë dhe prokuroia doli në përfundimin që këto prona duhet të kthehen në shtet , në gjykatën e apelit në Kavajë u rikthyen shtet, në apelin e Durrësit u rikthyen shtet me një fjalë të gjithë pronat janë me certifikata të pavlefshme por duhet pritur se mund të ankimohet dhe mbi apelin Kështu që Spilleja gati 90% është e ndarë me certifikata pronësie.

-Largohet nga mbledhja pas 1 ore ; 11 min ; 30 sek të zhvillimit të saj këshilltari z. Shpati Kolgega dhe këshilltari z. Enver Memolla.

Artur Kaja . Të paligjshme sepse prokuroria dhe gjykata i ka rrëzuar. Edhe diçka tjetër se ne kemi shumë toka themi që Rrogozhina ka 20 mijë hektarë toka bujqësore por jo të gjithë tokat bujqësore janë në administrimin të bashkisë sepse kur janë bërë inventarizimet në vitin 2011 nga ish komunat atëherë janë lënë selektive kjo parcelë ta kalojmë në komunë këtë e ka lënë pa emër dhe tani të gjithë këto parcelat që kanë mbetur pa emra ngelin ministrisë së bujqësisë edhe mund të qëllojë rasti që mund të vish ti si qytetartë thuash unë dua ta marr këtë parcelë në përdorim. Nëse varreza është mbi ullinjtë ...

Hekuran Xhani . Mos e lodhim Arturin. Turi rrofsh.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Artur.

Artur Kaja . Faleminderit ju.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me drejtorin e bujqësisë z. Elton Xhani.

Elton Xhani . Përsëndetje ! Për sa i përket kërkesës tuaj për informacion për planin e punës, kërkesës së Verit më saktë për muajt Mars dhe Prill...



-Kthehet në mbledhjen e këshillit pas 1 ore ; 13 min: 20 sek të zhvillimit të saj këshilltari z.Enver Memolla.

Elton Xhani planet e punës bëhen vetëm për një muaj dhe jo për dy muaj por kemi bërë një përjashtim kemi sjellë dy muaj bashkë që Veri ti shikojë edhe këshilltarët ta shikojnë më së miri. Planin e keni këtu të shkruajtur , kurse për pikën e dytë kontaktova direkt me drejtorin e urbanistikës , për pikën e dytë projektin e korridorit të 8 nuk është se kemi ndonjë informacion si drejtori si zyrë e bujqësisë është kompetencë e ARSH-së dhe projekti i ARSH-së i ka kërkuar shkresë drejtorja e Urbanistikës presim përgjigje nga ato. Tani dy pikat që i lamë herën e fundit pa informacion që ishte prita në Sinaballaj që u drejtua nga z. Altin mora informacion janë çuar të gjitha shkresat në Ministrinë e Bujqësisë dhe është kompetencë e Ministrisë së Bujqësisë presim tani ... Andin kemi fatin e mirë që e kemi këtu.

I kam dërguar shkresë policisë bashkiake të heqin ato çfarë janë aty, tani skrepin unë do ta sjell kamioni nuk është në gjendje funksionale tani për momentin se duhet me i hequr ato kallamat nga aty. Altin sa dua unë ta nxjerr veten mirë nuk do ti.

Altin Tosku . Na e kap syri përditë.

Andi Proshka . I kemi thënë zyrtarisht që të mos i bëjmë dëm nëse ai nuk i heq brenda afateve.

Altin Tosku . Nëse ai nuk i heq brenda afateve gjobë se na u bë Teqja, tani u bënka anash rruga nuk na bie mendja para qytetit tonë, para qytetit tonë për pastrim dhe shumë gjëra nuk na bie mendja për asgjë . Po po ne po e bëjmë kalojmë dhe vijmë pas një muaji prap.

Elton Xhani . Pjesa tjetër për sa i përket përroit në Sinaballaj i kam çuar shkresë edhe bordit kam folur dhe vetë personalisht me drejtorin e bordit, kam qenë dhe vetë prezent atje do e gjejnë ato mundësinë do sjellin skrepin krahëgjatë për ta pastruar sepse e di ma ka shprehur dhe Gëzimja shpesh herë këtu në këshill që është problematikë , është me të vërtetë problematikë që duhet me e zgjidhur po nu e solli do fusim mjetet tona brenda.

Mukades Gixhari . z. Enver Memolla.

Enver Memolla . Unë jo pa qëllim ja çova shkresën drejtorit sepse në mbledhjen e kaluar unë i kam bërë një kërkesë dhe këtu vetë drejtori tha që brenda Marsit do jetë kryer data 20 nuk është kryer qëllimi im kësaj shkrese ka qenë kanali i dëmtuar nga punimet që janë bërë për pastrimin e kanaliti të Zogut dhe një kanal të dytë që është kanal vaditës për dy blloqe e ke të papastruar akoma më ndodh që në planin e punës unë kam hyrë tek ASIG dhe e kam parë kanali numër 731 nuk është...



Elton Xhani . Vetëm dielli besoj se i çon të gjitha rrezet e veta në territorin e tokës ne nuk i bëjmë dot të gjitha ne po bëjmë kanalet e dyta që janë më të mëdhenj pastaj do shtojmë ato që janë më të vegjël sepse Veri ka këtë kanal in aty, Saimir a kanal in Gërmenj.

Enver Memolla . Qetësohu pak merr frymë sepse po dalim në debat ky nuk është debat personal, se personal vi tek zyra jote unë, tani po të them nuk po të them dhe po ta lë si mbledhja e kaluar...

Elton Xhani . Nga mbledhja e kaluar të kam thënë do shoh kanal in e Zogut se më ke thënë që ka betona dhe unë kam shkuar me përgjegjësin e punës...

Enver Memolla . Nuk të ndërpreva dhe mos më ndërpre. Unë po them bazuar në shkresën tënde nga informacioni që kisha kanal in nr.731 nuk është pjesë e planit të punës që është kanal vaditës për dy blloqe nënkryeari e di se e kam vënë në dijeni që para tre ditësh... Nga punimet që keni bërë janë bërë dy gjëra gabim e para nënkalimi që kalon uji në kanal është i bllokuar dhe është thyer tuba po të vë në dijeni kam dy muaj që të kam vënë në dijeni, e dyta...

Elton Xhani . Nënkalimin ke dy muaj që ma kë vënë në dijeni?

Enver Memolla . Kemi qenë bashkë tek parcela me skrepistin unë nuk kam audio regjistrim por ta them dhe ku ishim.

Elton Xhani . Në rregull.

Enver Memolla . Dhe të kam thënë në atë kohë kur isha atje zotëri je këtu bravo për punën. Ta kam thënë? Dhe të kam thënë meqë je këtu duhet të bësh patjetër këtë se e ke nxjerr jashtë loje. Tani pyetja që po them nga masat që ke marrë për vaditjen derisa ti këtë kanal vaditës sot me pompa me nivel nuk e ke futur në plan pune, kur do e fusësh?

Elton Xhani . Nëse e ve re aty planin e punës ke në fund të ndryshme në bazë të situatës, tani mjetin e madh...

Enver Memolla . Në bazë të situatës ke thënë që brenda Marsit e ke të kryer.

Andi Proshka . Një pyetje teknike tani është prishur ura mbikalimi?

Enver Memolla . Andi ka një problem tani, unë ja kam thënë meqenëse je këtu hajde



bashkërisht ta mbarojmë deri në fund nuk e bëri. Pjesa e dyë tani kanali i Zogut është ulur apo jo është pastruar?

Andi Proshka . Po.

Enver Memolla . Dhe disniveleli është disnivelel, nga pastrimi është taposur ajo tuba ku kalon uji, është thyer tuba e parë që është bërë zero .

Andi Proshka . Çfarë tube është?

Enver Memolla . Një mijësh në mos gaboj nuk të gënjej dot se është brenda në beton. Tani unë këtë masë kam kërkuar që hapni këtë që të iki të kalojë dhe uji sepse ai kana edhe nga kanali që vjen nga përroi i Shimve që mund ta taposi prap vijën e Zogut bën kullimin që të mos përmytet parcelat poshtë që ti i di ku janë dhe unë këtë po kërkoj. Unë ta kërkoja dhe mbledhjen që kaloi the brenda Marsit e ke të mbyllur.

Andi Proshka . Janë ca punë që nuk i bën dot me skrepin e madh .

Enver Memolla . Jo skrepi madh skrepi vogël. Me llogjikë unë po them meqenëse tek plani i punës nuk e ke futur kur do e marrësh planin e masave për vaditjen ?

Elton Xhani . Ver e kisha dhe plan në Mars, zotëria që unë kam skrepist me skrepin e vogël ka marrë muajin e lejes tani unë nuk kam se çfarë, të shkoj ta përdor vetë skrepin atje. Kohë kemi dhe nuk është se e lashë pa bërë.

Enver Memolla . Tani dëgjo një sekondë unë as po të akuzoj ... Tani dëgjo dhe një sekondë Toni unë e di këtë pjesën që nuk e keni ju kam folur dhe me Tomini po flas për pjesën e Koridorit 8 sepse në dijeni po flasim janë tre projekte . Ajo çfarë unë kam thënë është që ne si këshill bashkiak , meqenëse bashkisë Rrogozhinë nuk i ka kthyer akoma shkresë ARSH-janga shkresa e fundit ndaj e çova deri në këtë pikë që ne si këshill bashkiak t'i bëjmë një shkresë ARRSH-së që ta sjelli hartën gjurmën ku prek ajo rrugë.

Elton Xhani . Sepse ja ka nisur dhe Tomi.

Enver Memolla . E di shumë mirë se i kam hyrë vetë personalisht kësaj pjese për tokat e Rrogozhinës që të mos ndodhi ajo që ndodhi me bypass-in , pa rrugë dytësore pa kanalizime pa hyrje urë dalëse. Ta bëjmë parapritë pa filluar projekti sepse nëse bllokohen dy rrugët Andi e di



rruga e fermës pa nënkalim poshtë pastaj mbille plep nuk e kemi me ju këtë pjesë e kemi në ndihmën tuaj.

Andi Proshka . E marr vesh, shkreesën tonë e keni të gatshme merreni dhe përcillen .

Enver Memolla . Prandaj po them si këshill bashkia t'i dërgojmë një shkresë ARRSH-së për vënien e...

Hekuran Xhani . Do bëhet dhe shpronësimi i tokave me atë duhet të merret bashkia, zyra urbanistike. Me këtë të bujqësisë tonë kam unë problem, mbarove ti?

Altin Tosku . Atë pjesën e asaj rrugës që ka rënë dheu?

Elton Xhani . Ajo pjesa është kanali i bordit i kam çuar foto, shkresa e kam marrë në telefon dhe i kam thënë hajde shihese po rrezikon jetën e njerëzve e kam biseduar dhe me kryetarin...

Altin Tosku . Priske fare dhe atë pjesën tjetër...

Andi Proshka . Kemi dritë jeshile që ai kanali mund të betonizohet i gjithi.

Elton Xhani . I kemi kërkuar 1 km nga aty të githin 1 km, e gjithë pjesa e qytetit të jetë e betonizuar mos jetë më më hyri uji tek baçja më hyri uji tek themelet më hyri uji këtu apo atje.

Altin Tosku . Ishalla po e bëni.

Andi Proshka . Nuk e bëjmë ne bordi i kullimit.

Hekuran Xhani . Tani unë pashë këtë projektin dhe e vlerësoj , pra bashkia po merr përsipër përgjegjësitë që ka dhe detyrimet kundrejt qytetarëve sepse janë 12.8 km kanal. Unë këtu kam një pyetje deri kur do realizohet ky projekt që ti ke sjellë në Këshill pra afati. Është hera e parë që unë shoh kaq se herën tjetër ishin 4.6 km tani është 4-fishuar unë aty ku punohet jap dhe falenderimet e mija por kur do realizohen kët se mos na ngel për herë tjetër .

Elton Xhani . Kjo është për Marsin dhe Prillin, tani ...

Hekuran Xhani . Bravo po të japim dhe gjysmën e Majit, tani kam diçka tjetër kemi dy mjete si bashki a janë në gjendje pune dy mjetet?



Elton Xhani . Po.

Hekuran Xhani . Sepse shumë mirë po vazhdon me mjetin e madh unë po e shoh po punon në Luz shumë mirë . Për mjetin e madh kam një propozim këshillit bashkiak dhe nënkryetarit të bashkisë që mjeti i madh të jetë me dy punëtorë . Pra meqë e kemi situatën e shkurtër le të punësohet një nuk ka të bëjë me fushatën kjo se dikush më tha, që mjeti të punojë 10-12 orë në ditë sepse dhe punëtori që paguhet në shtet 6 - 8 orë punon nuk punon mund t'i thuash puno se kam hall unë se ai rrogë shteti merr nuk është privat që të punoje dhe natën. Pra propozoj këshillit jeni dakord ju anëtarët e këshillit që mjeti madh të dublohet dhe ti kërkohet llogari të punojë 12-14 orë në ditë. Kurse mjeti i vogël duhet të merret me kanalet e dyta vaditëse sepse i ka mbytur ferra. Unë kaq kam dalsh faqebardhë në realizimin e projektit.

Mukdes Gixhari . E falenderojmë drejtorin e bujqësisë për informacionin. Tani vazhdojmë me kërkesën nga Gentiana Uku është një nënë e divorcuar me një djalë 17- vjeç, është divorcuar që në moshë të mitur me djalin.

Hekuran Xhani . Kërkesa e saj lexoje çfarë ka kërkuar të paktën.

Mukades Gixhari . Po pra kjo është Gentiana Uku një nënë e divorcuar me një djalë 17 vjeçar nuk ka shtëpi është divorcuar që në moshë të mitur jeton tek prindërit e vet dhe kërkon nga këshilli bashkiak një ndihmë financiare për analiza për shëndetin sepse nuk... Atëherë kush e njeh, unë e njoh e njihni dhe ju?

Hekuran Xhani . E njoh dhe unë.

Mukades Gixhari . Janë me dy prindër 90 - vjeçarë, jeton me dy pleq që nuk janë për veten e vet..

Hekuran Xhani . O Indrit është divorcuar është vetë tani nga streset që ka kaluar është e sëmurë ka dhe një fëmijë që do ta nxjerri në jetë për të vazhduar shkollën e mesme pra ka nevojë për një përkrahje të ndjejë dorën e pushtetit lokal dhe këshillit funksional që i vjen në ndihmë qytetarit.

Mukades Gixhari . Atëherë kemi dhe një kërkesë tjetër nga unë i nënshkruari Nazmi Qerim Saraçi banor i Njësisë Administrative Gosë ju bëj me dije që në Gosë të Madhe para dy vitesh më është djegur 1 ha vreshta, zjarri shkrumboi totalisht parcelën time me vreshta dhe materialet e tjera mbajtëse në shërbim të vreshtit , të pranishëm ishin dhe zjarrfikësit por pa arritur të shpëtonin asgjë. Nëse doni të verifikoni parcela gjendet akoma në gjendje të mjerueshme pas



zjarrit mund të vini në çdo kohë. Duke qenë se dëmi është shumë i konsiderueshëm i bëj thirrje këshillit bashkiak të më ndihmojë financiarisht që sërsish ta ribëj funksionale këtë parcelë. Zotëria ka sjellë dhe certifikatën AMTP. Këto dy kërkesa janë kemi dhe një tjetër që nuk është për persona është... tani dhe për këtë të Nazmi Saraçit të nderuar kolegë...

Mukades Gixhari . Ja kalojmë fjalën z. Adriatik Leka.

Adriatik Leka . Përshëndetje ! Atëherë rasti konkret qytetari që bën kërkesën zjarri ka ndodhur me gjithë mend por emergjenca civile vihet në lëvizje në zbatim të ligjit 45/2019 dhe të akteve të saja. Në momentin që qytetari nuk vihet në lëvizje me këtë ligj atëherë atij i lind e drejta ose dëshira t'i kërkojë ndihmë këshillit në rastin konkret nuk përfiton nga ligji jonë për shumë e shumë arsye të tjera prandaj i është drejtuar këshillit. Se në qoftë se do ishte në fuqi ligji jonë brenda 5 ditëve do kishte mbaruar okumentet të gjitha ishte përgatitur dosja dhe vinte po në këshill për miratim. Por në rastin që një nga nenet që ai parashikon që ky nuk përfiton dot atëherë ky i drejtohet këshillit për ndihmë por jo për dëmshpërblim nuk ka rëndësi është 1 ha është 2 apo 3, tani qytetari thotë ndihmë sepse tek ligji jonë ka shumë mbërthecka tjera që nuk... fermerët në 90% të rasteve nuk arrijnë dot t'i plotësojnë kriteret, tani këshilli...

Andi Proshka . Fermeri duhet të jetë i siguruar me libër fermeri.

Adriatik Leka . Kështu ka rrush, ka ullinj, ka bar, ka byk, ka gjëra tjera.

Enver Memolla . Kemi pasur një rast për djegie bari nuk di që të kemi kaluar sepse kemi dëgjuar dhe emergjencat civile që thotë nuk ka plan biznesi pastaj për ndihmë 50 mijë lekë pastaj e vendos vetë këshilli këtë pjesë por të tjerët nuk e kanë marrë 50 mijë lekëshin 2-3 raste janë bërë që janë marrë 50 mijë lekë por duhet parë dhe kjo pjesë sepse janë djegur 1000 e ca rrënjë ullinj na hapet vallja pastaj do vinë të gjithë njerëzit, i ka ngordhur bagëtia atje.

Andi Proshka . Tani zotëria do t'i kompesohet parcela apo do ndihmë ekonomike?

Enver Memolla . Këshilli deri në 500 mijë lekë jep.

Adriatik Leka . Drejtori i Eemergjencave e falenderojmë shumë për sqarimet shumë korrekt je.

Mukades Gixhari . Të nderuar këshilltarë Nazmi Saraçi se na takoi para se të vinim ka dhe një fëmijë në moshë 40 vjeçare që është invalid, është e vërtetë?



Besnike Coraj . Po, fëmija i parë.

Indrit Dedej . Ka për t'i dhënë një 500 mijë lekësh apo nuk ka?

Mukades Gixhari . Pra përveç zjarrit ka dhe pjesën e fëmijës. Pra ne jemi dakord që të ja përcjellim...

Enver Memolla . Kryetare mos e zgjat të dyja kërkesat t'i paraqiten bashkisë Rrogozhinë dhe të marrin kompetencat të sjellin projektvendimin në këshill bashkiak .

Mukades Gixhari . Në mbledhjen e radhës.

Hekuran Xhani . Tani Veri janë dy familje në nevojë në rast se ne vazhdojmë këtë procedurën e zjarreve të shkojë në bashki të vijë këtu harrohet sepse shumë vendime ne i kemi harruar po të kujtoj vendimin e 31 Dhjetorit për disabursa për fëmijët që ishin në gjendje merrnin përkrahje sociale thamë do të ndryshojmë buxhetin pas vitit të ri dhe do t'i fusim këto familje në nevojë ... u harrua. Tani dhe këto nuk na e lejon ligji ne se nuk marrim një vendim që nuk e konfirmon Prefekti ne do miratojmë dhe administrata zyra e financave të caktojë shumën .

Enver Memolla . Të vijë projektvendimi ta miratojmë .

Indrit Dedej . Nuk kalon pa projektvendim.

Mukades Gixhari .Të nderuar Këshilltarë kemi dhe një kërkesë për dokumentacion, nisur nga kërkesat e shumta të qytetarëve të bashkisë Rrogozhinë si dhe shkresës së ardhur nga anëtarët e këshilli bashkiak nr.1152.prot datë 17.03.2025, kërkojmë nga Institucioni juaj kopje të projekt zbatimit të gjurmës së rrugës që përshkon autostrada Elbasan- Rrogozhinë - Lekaj.

Hekuran Xhani . Këtë e diskutuam atë që tha Veri këtë e mbaruam ne. Në mbledhjen e kaluar ishte shefi i zyrës së financave dhe na sollti një projekt për fondet e prapambetura të vitit të kaluar këto fonde unë kërkoja që herën tjetër ta miratonim t; i vejmë në funksion të këtij viti kështu që ai shefi të paktën herën tjetër të na sjelli atë projektin se unë pata fatin ta lexoj dhe ai nuk kishte asgjë të keqe ca fonde që nuk janë shpenzuar t'i shpenzojmë t'i kalojmë pra mbledhjen e radhës ...

Mukades Gixhari . Tani ai thotë për arsye shëndetësore sot prandaj nuk e ka...



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Hekuran Xhani . Duhej të futej në rend dite, nejtse.

Altin Tosku . Pastrimet e rrugëve janë shumë keq , anësoret mbeturina janë shumë keq në çdo cep .

Andi Proshka . Duhet të flasim sipas rastit.

Altin Tosku . E vetmja gjë të mirë që kemi ne është që kemi relievin e mirë po mos kishim relievin ishim mbytur komplet.

Andi Proshka . Nëse ke një rast më thuaj ku është ta verifikojmë ku është.

Mukades Gixhari . Meqë nuk kemi më diskutime mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur. Faleminderit tw gjithëve.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 14 : 00^{oo} . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 1 orë ; 42 min ; 10 sek.
- Ky procesverbal mbyllet në faqen 31 (tridhjetë e një).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

Sekretari i Këshillit
Ervis Shera